



---

**Projekti: Përforsimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare**

---

Shkup, 27.04.2017

**Këshillim mbi „Riorganizimin e debitorit në kushte të procedurës paraprake – aspektet normative dhe praktika gjyqësore“**

Më 27 prill 2017 u mbajt këshillimi i shtatë dedikuar procedurës falimentuese, me temë „Riorganizimi i debitorit në kushte të procedurës paraprake – aspektet normative dhe praktika gjyqësore“. Janë përfshirë aspektet normative dhe praktika gjyqësore e riorganizimit jashtëfalimentues, konteksti evropian me praktikatat më të mira, dhe u prezantuan dy studime të rasteve të riorganizimit të suksesshëm të kompanive në rajon.



Përfaqësues të Ministrisë së ekonomisë, administratorë falimentimi, gjykatës falimentimi dhe gjykatës që punojnë në lëndë që dalin nga procedura falimentuese, juristë dhe përfaqësues të institucioneve të tjera, që ishin prezent në këshillim, patën mundësinë të njoftohen me një materie jo shumë të ekzaminuar në praktikën tonë, duke patur parasysh faktin se që nga viti 2014 janë realizuar vetëm dy riorganizime jashtëfalimentuese, e as administratorët falimentues nuk shprehin interes të veçantë për riorganizimin, ndoshta edhe për shkak të ndikimit më të madh që e kanë drejtorët sipas ligjit. Propozimin për riorganizim mund ta parashtrorë vetëm drejtori, procesi fillon me miratimin e planit për riorganizim, që nënkupton përfshirjen e më shumë organeve dhe koordinim të shumë aktiviteteve rrjedhëse. Rëndësi të jashtëzakonshme ka momenti kur organet drejtuese do të vendosin ta sanojnë biznesin, respektivisht a do të bëhet kjo kur kriza është strategjike – kur është e sigurt se sanimi mund të jetë i suksesshëm, apo më vonë, kur kemi të bëjmë me krizë të të ardhurave, respektivisht kur bëhet fjalë për paaftësi të sigurt paguese, dhe kur janë ndezur dritat e verdhë por edhe ajo e kuqe, ndërsa shanset për sukses zvogëlohen dhe kërkohet sanim operativ.

Në vendet e BE-së, për arsye të shumta, sanimi po bëhet gjithnjë më i rëndësishëm, ndërsa modelet për realizimin e tij, edhe pse të shumëllojshme, përsëri kanë të vetmin qëllim – kapërcimin e insolvencës dhe shpëtimin e të ardhmes së kompanisë. Në pajtim me direktivën e BE-së për korniza për ristrukturim preventiv, vendet anëtare përpilojnë një Model planesh për ristrukturim dhe i vendosin në dispozicion online, ndërsa firmat mund të zgjedhin a do ta shfrytëzojnë atë. Afati për përpilimin e planit është 30 ditë, ndërsa sipas kushteve minimale për vërtetimin e tij, duhet të miratohet në pajtim me kërkesat për votim, të jetë dorëzuar deri te të gjithë kreditorët e njohur, të jetë në përputhshmëri me testin për interesat më të mira të kreditorëve, dhe çdo financim i ri të jetë për zbatimin e planit.

Modeli konceptual i riorganizimit Spin-Off, i prezantuar gjatë këshillimit, ka përparësi të shumta, si transformim transparent i pronësisë, shlyerja më e volitshme e kërkesave të kreditorëve me procedurë tenderike, është obliguese për të gjithë pjesëmarrësit, procesin është i kontrolluar nga gjykata, ndërsa pas votimit edhe nga një person i autorizuar për mbikëqyrje të përmbartimit, kështu që rezultati është i njohur dhe i dakorduar paraprakisht. Si vërtetim për efikasitetin, të pranishmëve iu prezantuan projekte të suksesshme të këtij lloji të ristrukturimit, përmes kontrollit konkret në realizimin e planit dhe të gjithë dokumenteve të vërtetuara shoqëruese.

Projekti „Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare,“ realizohet me mjete të Instrumentit për Asistencë Para-Aderimit (IPA) të Bashkimit Evropian ndërsa zbatohet nga ana e konsorciumit të udhëhequr nga Pohl Consulting & Associates, në partneritet me Ernst&Young.